

## Informacion i Pergjithshem Periodik Q2 -2015

Raiffeisen Bank sh.a, shoqeri aksionare me seli ne "Rruga e Kavajes, Pall 71, Shk.1, Ap.4, Tirane" e themeluar me date 10.06.1997 bazuar ne vendimin e gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 17828, mbajtes i NIPT J61911005B

Kapitali: 14.178.593.030 leke

Vlera e kapitalit te shlyer: 14.178.593.030 leke

Numri i aksioneve: 7.000

Aksione te zakonshme me vlere nominale secili: 2.025.513,29 leke

Aksioner i vetem: Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me seli ne Am Stadtpark 9 Wien, Austri, mbajtes i 100% te aksioneve.

Raiffeisen Bank sh.a eshte pjese e grupit nderkombetar Raiffeisen Bank International AG (RBI), grup i cili eshte nje nder lideret kryesore ne Austri dhe qe eshte i shtrire ne mese 15 shtete te Europes Qendrore dhe Lindore me ane te bankave te rrjetit. Raiffeisen Bank International AG zoterohet nga Raiffeisen Zentralban Osterreich AG (RZB) e cila mban rreth 60.7 perqind te aksioneve ndersa pjesa tjeter, jane aksione te kuotuar lirish ne burse dhe zoterohen nga investitore private.

Raiffeisen Bank sh.a zoteron ne Republiken e Shqiperise shoqerite e meposhtme:

- 100% te aksioneve te *Raiffeisen Invest sh.a - Shoqeri Administruese e Fondeve te Pensionit dhe Sipermarrjeve te Investimeve Kolektive* me adrese ne "Tirane, Bulevardi "Bajram Curri",ETC,kati i 10"
- 75% te aksioneve te *Raiffeisen Leasing Sh.a* me adrese ne "Tirane, Bulevardi "Bajram Curri",ETC,kati i 10"

Raiffeisen Bank sh.a ushtron aktivitet bankar ne Republiken e Shqiperise bazuar ne Licencen nr. 02/1 akorduar nga Banka e Shqiperise, duke ofruar sherbimet/produktet si vijon:

- ✓ Te gjitha format e kredidhenies, duke perfshire edhe kredine konsumatore dhe kredine hipotekore;
- ✓ Qirane financiare;
- ✓ Te gjitha sherbimet e pagesave dhe te transferimit te parave;
- ✓ Ofrimin e garancive;
- ✓ Tregtimin per llogari te saj ose per llogari te klienteve, qofte dhe ne nje kembim valutor, ne nje treg te vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si me poshte:
  - i) Instrumente te tregut te parase (çeqe, deftesa, certifikata te depozitave etj),
  - ii) Kembim valutor,
  - iii) Produkte derivative (instrumente derivative), duke perfshire, midis te tjerave, kontrata te se ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options),

- iv) Instrumente te kembimeve valutore dhe instrumente per vleresimin e normes se interesit, duke perfshire ketu produkte te tilla, si marreveshje swap dhe marreveshje qe percaktojne vleren e interesit ne te ardhmen,
- v) Letra me vlere te transferueshme,
- vi) Instrumente te tjera te negociueshme dhe active financiare duke perfshire veprimet me arin,
- vii) Pjesemarrjen ne emetimin e te gjitha llojeve te letrave me vlere, duke perfshire nenshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik ashtu edhe privat) dhe kryerjen e sherbimeve lidhur me keto emetime,
- ✓ Ofrimin e sherbimit te kasave te sigurimit ;
- ✓ Ndermjetesimin per transaksione monetare te meposhtme:
  - i) Administrimin e aktiveve te tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja ne kujdestari, sherbimet depozituese dhe te besimit,
  - ii) Sherbimin per kompensimin dhe shlyerjen e pagesave te aktiveve financiare, duke perfshire letrat me vlere, produktet derivative dhe instrumenta te tjera te negociueshme.
- ✓ Emetimin dhe administrimin e instrumenteve te pageses (te tilla si kartat e kreditit dhe te debitit, ceqet e udhetarit dhe ceqet bankare, kartat e pageses dhe dhe pagesat me celular) etj, perfshire emetimin e parase elektronike.
- ✓ Sherbimet keshilluese, ndermjetesuese dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha veprimtarite e perfshira ne licencen e dhene nga Banka e Shqiperise, duke perfshire referencen e kredise dhe te analizes, kerkimin dhe keshillimin ne lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe keshillimin mbi blerjet e mbi strategjine dhe ristrukturimin e shoqerive.
- ✓ Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare
- ✓ Ndermjetesim ne sigurime dhe risigurime.

### **Struktura dhe pergjegjessite e Organeve Drejtuese**

#### **Keshilli Drejtues:**

Helmut Breit	- Kryetar
Heinz Hödl	- Zevendeskryetar
Andreas Engels	- Anetar
Harald Kreuzmair	- Anetar
Razvan Munteanu	- Anetar

#### **Pergjegjessite:**

**Këshilli drejtues** ka përgjegjësitë kryesore, të cilat përfshijnë, midis të tjerave:

- a) miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin rrezikut, buxhetin vjetor;
- b) përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;
- c) monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;

- c) krijimin e komiteteve, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
- d) përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;
- dh) monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
- e) marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
- ë) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;
- f) mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

#### **Komiteti i Kontrollit**

Heinz Hödl	- Kryetar
Johannes Kellner	- Zevendes kryetar
Susanna Benoit	- Anetar

#### **Komiteti i kontrollit ka këto detyra:**

- a) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
- b) shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
- c) propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;
- ç) bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
- d) kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;
- dh) i jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
- e) miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

#### **Drejtorja/Bordi i Menaxhimit**

Christian Canacaris	- Drejtori i Pergjithshem
Alexander Zsolnai	- Zevendesdrejtor i Pergjithshem
John McNaughton	- Anetar Bordi per Biznesin Retail

Raphaela Bischof-Rothauer - Anetare Bordi per Operacionet dhe TI-ne

## Drejtoria

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.
2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.
3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.
4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

## Politika e konfliktit të interesit në Raiffeisen Bank Shqiperi

### **1 PËRCAKTIME DHE KUFIZIME**

#### **1.1 Përcaktimi i konfliktit të Interesit**

Konflikti i interesit midis ofertës dhe kërkesës është ekzistent në çdo transaksion bankar, ashtu si në çdo transaksion tjetër në sistemin tonë ekonomik. Interesi i një pjesëmarrësi tregu është arritja e konflikteve më të mëdha të mundshme me interesat e pjesëmarrësit tjetër duke paguar çmimin më të ulët të mundshëm për vlerën më të lartë të mundshme. Nuk ka ndonjë konflikt interesi të palejueshëm për aq kohë sa ky konflikt interesi zgjidhet në mënyrë të përshtatshme në treg me një marrëveshje të përshtatshme që është në pajtim me atë që dy partnerë të ndershëm biznesi do të arrijnë në mënyrë të arsyeshme.

#### **1.2 Konfliktet e Palejueshme të Interesit**

Konfliktet mund të lindin kur banka vendos interesat e saj ose të një pale të tretë mbi interesat e klientit për qëllime të një avantazhi financiar, përtej sjelljes së përshtatshme për tregun përmendur më lart. Banka duhet të identifikojë paraprakisht, situatat e mundshme në të cilat mund të lindë kjo sjellje e bankës ('konfliktet potenciale të interesit') dhe për të marrë masa për të ndaluar që ato të ndodhin ( shih pikën I, 3).

#### **1.3 Palët e Përfshira në një Konflikt Interesi**

##### **1.3.1 Kategoritë e Personave të Përfshirë**

Konfliktet e palejueshme të interesit mund të ndodhin midis klientëve të bankës dhe

- Vetë bankës
- Personave që punojnë për bankën( bordi drejtues, punonjësit, kontraktuesit e pavarur, komisionerët të marrë me kontratë),
- Kompanitë e kontrolluara nga banka,
- Klientët e tjerë të bankës.

### **1.3.2 Kompanitë e Kontrolluara nga Banka**

Një kompani është e kontrolluar nga banka në qoftëse banka:

- Ka të drejtën e shumicës së të drejtave të votimit të aksionerëve, ose
- Ka të drejtën e një aksioneri për të emëruar apo hequr shumicën e administratës, organeve drejtuese ose mbikqyrëse, ose
- Ka të drejtë të ushtrojë një influencë kontrolluese, ose
- Mund të vendosin mbi ushtrimin e të drejtës së votës së shumicës për emërimin apo heqjen e shumicës së anëtarëve të bordit drejtues ose mbikqyrës bazuar në një marrëveshje të aksionerëve me aksionerët e tjerë.

Kompanitë e kontrolluara nga banka, në fushën ku ata kryejnë transaksione në instrumentat financiarë, janë kërkuar të pajtohen me udhëzimet aktuale, e bëjnë të gjithë informacionin e parashikuar aty të mundshëm për bankën dhe parashtrajnë raporte.

### **1.3.3 Përkufizimi i ‘Grupit’**

Një grup (Grupe) përgjithësisht konsiston në një kompani mëmë, filjalet e kontrolluara nga ajo kompani mëmë, si përshkruhet më lart dhe të gjitha kompanitë në të cilat kompania mëmë apo një filjal direkt ose indirekt mban një interes më të madh se 20%.

Përveç kontrollit të marrëdhënieve të përshkruara më lart, banka duhet të pajtohet gjithashtu me këto udhëzime në lidhje me kompanitë e tjera që i përkasin të njëjtit grup, në qoftë se banka është e vetëdijshme për rrethanat që paraqesin një mundësi për konflikt interesi në termat e strukturës së aktivitetit të biznesit me kompaninë tjetër të grupit. Kjo bëhet e përshtatshme në veçanti në qoftë se dispozita të tjera ligjore parashikojnë një fluks të informacionit nga një kompani e grupit për bankën. Banka gjithashtu duhet të jetë në gjendje të përfshijë këtë informacion në rishikimin e mundësisë për konflikt.

## **2. IDENTIFIKIMI I KONFLIKTEVE POTENCIALE TË INTERESIT**

Departamentet dhe punonjësit e përfshirë janë përgjegjës për identifikimin dhe raportimin e konflikteve potenciale të interesit. Përputhshmëria do të mbikqyrë këtë dhe do ta zbatojë në qoftë se është e nevojshme.

Para se banka të hyjë në marrëdhënie biznesi apo interesa, apo punë në fushën e biznesit, punonjësit përkatës duhet t'i rishikojnë ato për mundësi konflikti interesi, duke marrë në konsideratë kategorinë e personave përshkruar në pikën 1.3, përfshirë kompanitë e kontrolluara (pika 1.3.2) dhe pjestarët e grupit (pika 1.3.3). Në qoftë se është identifikuar një mundësi e tillë, duhet raportuar Pëpruthshmërisë ('Raport i Potencialitetit'). Raporti i Poencialitetit duhet të përcaktojë përmbajtjen e mundësisë së konfliktit dhe personat që mund të ndikohen (klientët, punonjësit, palët e treta).

Përputhshmëria duhet të ofrojë informacionin e përshtatshëm dhe instruksione për departamentet apo punonjësit përkatës për t'i aftësuar ata që të identifikojnë konfliktet e mundshme të interesit dhe t'ia raportojë ato përputhshmërisë.

## **3 MASAT PËR PARANDALIMIN E REALIZIMIT TË KONFLIKTEVE POTENCIALE TË INTERESIT**

Masat e përshkruara më poshtë kanë për qëllim të parandalojnë konfliktet e palejueshme të interesit. Konfliktet e mundshme të identifikuar mbi bazën e masave parandaluese adresuar në pikën 2 nuk duhet të kthehen në konflikte faktike.

Masat e marra në fushat e biznesit të pjestarëve të Grupit RBI për të parandaluar konfliktet potenciale të interesit janë përshkruar në përgjithësi në pikat 3.1 dhe 3.2 më poshtë.

Në qoftë se bëhet e nevojshme, për arsye detyruese, të devijohet një nga masat e vendosura, një Specialist i përputhshmërisë duhet të njoftohet paraprakisht. Ai ose ajo do të pyetet për masat zëvendësuese. Çdo ndryshim i përhershëm i masave do të bëhet duke amenduar këto udhëzime.

Në qoftë se në një rast specifik biznesi, bëhet e nevojshme shmangia nga një masë e përcaktuar në këto udhëzime, duhet parashtruar një raport konflikti dhe duhet bërë një hyrje në listën e vëzhgimit të konfliktit (shih pikën 4)

### **3.1 Përshkrimi i Përgjithshëm i Masave**

Në përgjithësi, parimet e mëposhtme do të ruhen me qëllim që të parandalohen që konfliktet potenciale të interesit të bëhen faktike:

#### **3.1.1 Dhuratat dhe Përfitimet Për Punonjësit**

Në të gjitha fushat e biznesit, punonjësit përgjithësisht janë të ndaluar të pranojnë dhurata ose stimuj të tjerë.

#### **3.1.2 Veprimet subjekt Aprovimi**

Veprimet për të cilat një punonjës do të marrë aprovim paraprak me shkrim të pjestarit përgjegjës të bordit drejtues apo Përputhshmërisë janë parashikuar në Manualin e Përputhshmërisë.

#### **3.1.3 Pavarësia**

Individët e përfshirë në aktivitetet e shumëllojshme shoqëruar me një konflikt potencial të palejueshëm interesi të ndërmarra prej tyre me një shkallë të pavarësisë së përshtatshme për madhësinë e aktiviteteve të bankës dhe risku për të dëmtuar interesat e klientit.

#### **3.1.4 Kompensimi**

Kompensimi i individëve nuk duhet të ketë lidhje direkte me

- Kompensimin e paguar individëve të tjerë ose
- Të ardhurat e bëra nga persona të tjerë,

Në qoftë se ka ndonjë konflikt të palejueshëm interesi midis aktiviteteve të individëve të përfshirë. Kjo zbatohet sidomos për tregëtinë për klientin, të pronës.

## **3.2 Parime për Fushat Specifike të Biznesit**

### **3.2.1 Këshillimi i investimit dhe Analiza Financiare**

Interesi i Klientit veçmas do të merret në konsideratë kur ofrohen shërbime këshillimi. Kur rekomandohen instrumenta financiare, njoftimi për këtë fakt jepet në rekomandimin faktik dhe/ose në adresën e internetit të bankës.

Këshillimi do të behet në përputhje me parimin e konsultimit me bazë investitorin dhe investimin.

### **3.2.2 Analiza Financiare**

Analizat do të drejtohen në përputhje me parimet e analizave të duhura financiare.

### **3.2.3 Procesimi i Urdhërave të Klientit**

Veç nëse instruktohet ndryshe nga klienti, urdhrat e klientit zakonisht procesohen në përputhje me politikën e ekzekutimit të vendosur nga banka. Fushat përgjegjëse do të rishikojnë politikën e ekzekutimit mbi një bazë të vazhdueshme për të siguruar që është e përshtatshme për këtë qëllim. Përputhshmërisë duhet t'i merret mendimi paraprakisht për ndonjë ndryshim në politikën e ekzekutimit.

Çmimet në transaksionet në monedhë të huaj janë përcaktuar gjithmonë mbi bazën e kushteve të tregut aktual.

### **3.2.4 Kujdestaria**

Me qëllim për të mbrojtur të drejtat e klientit për instrumentat e tyre financiar dhe fondet, do të mbahen regjistrime korrekte mbi një bazë të vazhdueshme në përputhje me kërkesat ligjore për të siguruar që asetet e ruajtura për klientët individualisht mund të dallohen menjëherë nga njeri-tjetri dhe nga asetet e bankës në çdo kohë.

Përdorimi i instrumentave financiarë të mbajtura nga banka për klientin janë lejuar vetëm në qoftë se

- Klienti jep pëlqimin me shkrim paraprakisht për të përdorur nën kushte jashtëzakonisht të përcaktuara; në rastin e një klienti, kjo duhet të dokumentohet me anë të nënshkrimit të klientit.
- Përdorimi i instrumentave financiarë të klientit duhet të kufizohet për kushtet të përcaktuara specifikisht për të cilat klienti ka dhënë pëlqimin.

### **3.2.5 Tregëtimi i Pronësisë**

Banka tregëton për llogari të vetë vetëm në produkte të rrjedhshëm dhe për pasojë kjo lloj tregëtie nuk influencon tregun. Në rastin e porosive konkurruese, krijuesit e tregut dhe tregëtuesit e klientit janë instruktuar të japin prioritet ekzekutimit të porosive të klientit.

Në pikëpamjen e likuiditetit të lartë dhe kuotimeve të ngushta të tregut në kategoritë e asetëve të tregëtuara, siç është interesi, FX, bonot dhe equity që janë tregëtuar nëpërmjet shkëmbimit dhe/ose platformave të tregëtimit me kuotimet e standardizuara, nuk kërkohet ndarje tjetër (siç është ndarja fizike).

Nevoja për ndarje tjetër do të rishikohet me përfshirjen e Përputhshmërisë si pjesë e procesit të futjes së produktit kur shtohen produkte të reja.

Do të përcaktohen dispozita speciale mbi ndarjen e tregëtimit të pronësisë dhe tregëtimin e klientit në Librin e Normave të Thesarit.

.

### **3.2.6 Financimi**

Punonjësit që janë të përfshirë në financimin e një kompanie të veçantë nuk mund të ofrojnë ndonjë shërbimi konsulence për instrumentat financiarë që i shoqërohen asaj kompanie.

Në rast të vënies peng të letrave me vlerë, vlerësimi është kryer duke përdorur parimet standard të vlerësimit.

### **3.2.7 Menaxhimi i Portofolit**

Në menaxhimin e portofolit, produktet nga ofruesit palë të treta po ashtu edhe fondet Raiffeisen janë përdorur për të siguruar performancën më të mirë të mundshme të parave të investuara nga konsumatorët.

### **3.2.8 Shpenzimet/Llogaritë e shpenzimeve, Dhurimet, Bamirësitë dhe Sponsorizimet**

Kontributet në formën e shpenzimeve, donacioneve, bamirësisë dhe sponsorizimeve nuk mund të jepen me qëllim që të shmangen udhëzimet lidhur me pranimin dhe dhënien e dhuratave, rryshfeteve, pagesave me para të pista,

kontributet për partitë politike dhe personat e ekspozuar politikisht dhe dispozitat e mëtejshme të Kodit të Sjelljes së RBI, por mund të jepen ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në udhëzimet e Grupit.

#### **4 MASAT QË DUHEN MARRË NËSE NDODH KONFLIKTI I INTERESIT**

Në qoftëse ndodh një konflikt interesi në një rast faktik pavarësisht masave të ekspozuara në pikën 3., duhet ndjekur procedura në vijim.

##### **4.1 Raportimi i konfliktit Interesi**

Përputhshmëria duhet njoftuar menjëherë, pa përjashtim, në qoftë se ndodh një konflikt interesi, ose në qoftë se ka një dyshim të justifikuar se ka ndodhur një konflikt interesi (“Raporti i Konfliktit”). Raporti i konfliktit duhet të përcaktojë përmbajtjen e konfliktit dhe palët e ndikuara (klientë, punonjës, palë të treta) dhe hapat e propozuar nga njësi e biznesit për të zgjidhur konfliktin.

Përputhshmëria gjithashtu mund të kërkojë informacion dhe dokumenta në çdo kohë në qoftë se dyshon se ka një konflikt interesi.

##### **4.2 Dokumentimi i konfliktit te interesit**

Përputhshmëria duhet të dokumentojë Raportet e Konfliktit dhe çdo konflikt interesi që identifikon vetë.

##### **4.3 Hapat për të Zgjidhur Konfliktet Faktike të Interesit**

Specialisti i Përputhshmërisë vendos nëse duhen ndërmarrë hapa në lidhje me konfliktin përveç atyre që propozonte njësi e biznesit në Raportin e konfliktit; vendimi i tij/saj merret në mënyrë të pavarur mbi bazën e dispozitave përkatëse ligjore dhe këto udhëzime për trajtimin e konflikteve të interesit. Njësi e biznesit do të njoftohet për vendimin menjëherë. Nuk do të ketë influencë të papërshtatshme mbi Vendimin e Specialistit të Përputhshmërisë.

Në qoftë se janë të nevojshëm hapa të mëtejshëm, Specialisti i Përputhshmërisë do të njoftojë njësinë e biznesit për vendimin e tij/saj. Për të arritur në një vendim, ai ose ajo mund të konsultohen me ekspertë të brendshëm ose të jashtëm, në qoftë se është e nevojshme. Kjo duhet dokumentuar.

Për të vendosur hapat që duhen ndërmarrë, duhen bërë përpjekje për të trajtuar interesat e klientit, të cilit konflikti i interesit i vendos në një disavantazh

- Interesat e klientit me prioritet me te larte sa këto të bankës dhe individëve që punojnë për të dhe
- Interesat e klientit të barabartë në prioritet me ato të klientëve të tjerë.

## **II AVANTAZHET ( STIMUJT)**

### **1 PARIME**

Me qëllim të kryerjes së shërbimeve në një mënyrë që i shërben interesit të palëve, banka do të frenohet në pagimin, apo pranimin e komisionit, pagesa, apo përfitime jo-monetare (‘avantazhe’ ose ‘stimuj’) në qoftë se këto stimuj, nga natyra ose vlera e tyre janë në gjendje të dëmtojnë interesat e klientit në krahasim me interesat e vetë bankës dhe përfitimet e dhëna klientëve.



## **2 STIMUJT E LEJUAR**

Stimujt janë të lejuar vetëm në qoftëse janë prezent të gjithë kushtet në vijim :

- Ekzistenca, natyra dhe shuma e stimulit ose- në qoftë se shuma nuk mund të përcaktohet- mënyra e kalkulimit shumë apo rangjeve është zbuluar për klientin në mënyrë komprensive, me saktësi dhe në mënyrë gjithpërfshirëse para dhënies së shërbimit përkatës për letrat me vlerë apo shërbimet ndihmëse dhe
- Pagimi apo ofrimi i avantazhit është përgjithësisht- bazuar në kuptimin të paktën mbi një klient të caktuar dhe/ose grupe produktesh-projektuar për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të kryer për klientin dhe
- Nuk ka interferencë me detyrën e bankës për të vepruar në interesin më të mirë të klientit.

## **3. MARRJA E VENDIMIT NËSE STIMUJT JANË TË LEJUAR**

Speialisti i Përputhshmërisë duhet të rishikojë në avancë çdo marrëveshje sipas së cilës banka jep ose merr stimuj, me qëllim përcaktimin nëse ato janë të lejueshme ose jo. Marrëveshjet do t'i jepen Specialistit të Përputhshmërisë në avancë për këtë qëllim. Asnjë marrëveshje nuk mund të konkludohet për stimujt , në qoftë se Specialisti i Përputhshmërisë mendon se ajo është e papranueshme.

## **4. DEKLARIMI**

Pikat kyçe të një marrëveshje apo stimujt do t'i zbulohen klientit në një formë të përmbledhur. Detajet shtesë do t'i zbulohen klientit me kërkesën e tij/saj. Forma dhe përmbajtja e zbulimit duhet të aprovohet me shkrim nga Përputhshmëria.